

Titulli i rastit

Kompetencat e niveleve të ndryshme të qeverisjes në lidhje me arsimin parauniversitar:
Rasti shkollës “Fan Noli, Tiranë.

Fusha dhe niveli

Edukimi parauniversitar

Background:

Kompetencat e niveleve të ndryshme të qeverisjes në lidhje me arsimin parauniversitar:

- **Qeverisja vendore (bashkia):** përgjegjës për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar (Strategjia e decentralizimit neni 23/11). Sipas kësaj strategjia parashikohet që pushteti vendor të menaxhojë edhe burimet njerëzore, por aktualisht kjo nuk është vënë në zbatim - është përgjegjës vetëm për pagesën e rrogave të mësuesve të ciklit parashkollor.
- **Qeverisja qendrore/rajonale (ministra/drejtoritë arsimore):** përgjegjës për emërimet/shkarkimet e mësuesve, kualifikimet, trajnimet e mësuesve të arsimit parauniversitar.

Marrëdhëniet midis qeverisjes qendrore dhe njësive të vetëqeverisjes vendore: Marrëdhëniet ndërmjet organeve të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe institucioneve të qeverisjes qendrore bazohen në parimet e subsidiaritetit, të konsultimit dhe të bashkëpunimit për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta.

- **Strukturat e qeverisjes së shkollës:** Bordi i shkollës; Këshilli i Prindërve; Qeveria e Nxënësve.

Qeverisja efektive e shkollës siguron një pjesëmarrje aktive të aktorëve të ndryshëm. Prindërit janë partnerët kryesor të shkollës të cilët mund dhe duhet të përfshihen në mënyrë aktive në jetën e shkollës, si edhe të kontribuojnë në progresin dhe suksesin e institucionit. Po ashtu, nxënësit janë aktorë tepër të rëndësishëm.

Rasti që të përshkruhet më poshtë reflektton faktin se si struktura të ndryshme të qeverisjes me kompetencat të ndryshme përsa i përket fushës së edukimit ose tejkalojnë, anashkalojnë kompetencat e strukturave të tjera dhe nuk bashkëpunojnë në mënyrë efektive me njëri-tjetrin për të zgjidhur probleme të përbashkëta.

Përshkrimi i rastit

Prindërit e fëmijëve të shkollës “Fan Noli”, përkatësisht klasat II, III, IV janë vënë në dijeni nga drejtoria e shkollës vetëm një javë para fillimit të vitit akademik (*viti akademik filloi në 11.09.2017*), se fëmijët do të transferohen në një shkollë tjetër (*më konkretisht shkolla “Hoxha Tahsim”*)

Pikëpamjet e palëve të përfshira:

- 1) Prindërit e kundërshtuan këtë vendim duke shkruar një letër zyrtare drejtuar Drejtorisë Arsimore Rajonale, Tiranë dhe Bashkisë së Tiranës (datë 04.09.2017). Ata kanë parashtruar këto shqetësime:
 - **Konsultimi/pjesëmarrja e përfituesve në vendim-marrje:** Ata nuk janë konsultuar për marrjen e këtij vendimi, po ashtu as bordi i shkollës apo këshilli i prindërve;
 - **Koha e shkurtër e informimit:** Ata janë informuar vetëm një javë përpara fillimit të vitit të ri akademik, kohë kjo e pamjaftueshme për të marrë masa alternative. Për shembull, bëhet e pamundur rregjistrimi në një shkollë tjetër, pasi regjistrimet janë mbyllur.
 - **Distanca e shkollës së re nga vendbanimi:** Për shumë familje kjo shkollë është zgjedhur duke qenë më e afërta me banesat e tyre. Largimi i fëmijëve në shkollën e propozuar, për më tepër në një zonë që mungojnë mjetet e transportit publik e vështirëson transportin e fëmijëve. Ka një numër prindërisht që janë prindër të vetëm dhe largësia midis dy shkollave e bën të pamundur, nga ana logjistike respektimin e orarit si për në shkollë dhe në punë.
 - **Prishje ekuilibri:** Zhvillimi i mësimit me 2 turne është i vështirë si për fëmijën ashtu edhe për prindërit, pro prindërit tashmë e kanë gjetur balancën për të bërë të mundur ecurinë sa më të mirë të fëmijëve. Transferimi i fëmijëve në shkollë tjetër, vetëm pak ditë para fillimit të shkollës prish ekuilibrat e vendosur përsa i përket edukimit të fëmijëve.
- 2) Drejtoria Arsimore Tiranë në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë argumenton se marrjen e këtij vendimi ka patur parasysh intersin më të lartë të fëmijës, konkretisht mundësinë e mësimit me një turn dhe me kushte fizike bashkohore (kjo është përgjigjia zyrtare e DAR Tiranës ndaj letrës ankimore të prindërve).

Fëmijët e klasave II, III, IV të shkollës “Fan Noli” e nisën vitin e ri akademik në 11.09.2017 në mjediset e shkollës “Hoxha Tahsim”.

Analiza e rastit

Pa anashkaluar vlerën që ka zhvillimi i mësimit me një turn, si edhe pasja e godinave shkollore me infrastrukturë bashkëkohore, është e rëndësishme të parashtrohen disa pyetje:

A ka patur një konsultim dhe bashkëpunim paraprak midis qeverisjen vendore dhe asaj qendrore për nevojën rikonstruktimit të shkollës “Hoxha Tahsim” dhe më pas kalimin e disa klasave të shkollës “Fan Noli” në atë godinë?

- *Nëse Po?* Atëherë përse drejtorja e shkollës nuk është konsultuar me strukturat e qeverisjes së shkollës dhe ti bënte ata pjesëmarrës aktivë në këtë proces?
- *Nëse Jo?* A mund të përbëjë ky një rast të ushtrimit të kompetencave të qeverisë vendore pa u konsultuar dhe pa bashkëpunuar me qeverisjen qendrore (sic parashikohet në ligj)? Dhe më pas qeverisja qendrore, a vënë nën presion për të marrë një vendim në momentin e fundit duhet ti japi një zgjidhje situatës duke transferuar disa klasa të një shkolle tjetër për të bërë funksionale godinën e re (duke anashkaluar konsultimin me përfituesit e shërbimeve, prindërit, nxënësit).

Duke u bazuar në legjislacionin në fuqi në fushën e edukimit, vihet re se rasti në fjalë reflekton një vendimarrje të institucioni arsimor rajonal jo konform mënyrës se si parashikohet në ligjin

për arsimin parauniversitar. Evidentohet një tejkalim i kompetencave dhe një vendimarrje arbitrare, pa pjesëmarrje e përfituesve (duke mos marrë parasysh rolin e bordit të shkollës, rolin e këshillit të prindërve, të drejtat e prindërve, të drejtat e nxënësve të parashikuara me ligj).

Kuadri ligjor

Referuar **Ligjit no. 69/2012 "Për sistemin e arsimit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë"**

Neni 6 "Parime të përgjithshme" 8. Në sistemin arsimor parauniversitar garantohej e drejta e nxënësve, e punonjësve arsimorë, e prindërve dhe përfaqësuesve të tyre ligjorë, më poshtë "prindër", për të shprehur pikëpamjet e tyre për cilësinë e shërbimit arsimor dhe për t'u dëgjuar për këto pikëpamje. 10. Në sistemin arsimor parauniversitar garantohej e drejta e organizimit të nxënësve, mësuesve dhe prindërve për të mbrojtur të drejtat e tyre, si dhe për të dhënë ndihmesë në mbarëvajtjen e institucionit

Neni 62 "Të drejtat dhe detyrat e prindërve" 1. Prindërit janë partneri kryesor i institucionit arsimor në mbarëvajtjen e fëmijës dhe të institucionit. 2. Prindi ka të drejtë: b) të informohet për kushtet e sigurisë, të shëndetit dhe të mjedisit të institucionit dhe të kërkojë përmbushjen e tyre sipas standardeve të përcaktuara nga legjislacioni shqiptar; ç) të vihet në dijeni për drejtimit kryesor të veprimtarisë së institucionit dhe arritjet e institucionit në krahasim me institucione të ngjashme.

Neni 61 "Të drejtat dhe detyrat e nxënësit" b) nxënësi ka të drejtë të ndjekë institucionin arsimor publik që është në zonën e përcaktuar nga njësi bazë përkatëse e qeverisjes vendore

Neni 34 "Bordi i shkollës" states that: 1. Bordi i shkollës kontribuon për mbarëvajtjen e institucionit arsimor dhe i raporton për veprimtarinë e tij këshillit të prindërve; 2. a) Detyrat e bordit janë: miraton planin afatmesëm dhe atë vjetor të institucionit.

"Dispozitat Normative për Sistemin e Arsimit Parauniversitar 2013" aprovuar me Urdhër 343, datë 19.08.2013, të Ministrit të Arsimit.

Neni 102 "Detyrimet e institucionet arsimor ndaj prindërve" thuhet se 1. Prindi ka të drejtë të informohet nga institucioni arsimor për c) kushtet e sigurisë, shëndetit dhe të mjedisit të institucionit dhe të kërkojë përmbushjen e tyre sipas standardeve të përcaktuara në legjislacionin shqiptar.

Neni 103 "Këshilli i prindërve të institucionit arsimor" 1. Këshilli i prindërve ka të drejtë b) të shprehë pikëpamjet dhe të organizojë prindërit për të shprehur pikëpamjet për cilësinë e shërbimit të institucionit arsimor dhe të dëgjohej për këto pikëpamje. Drejtori i institucionit ka për detyrë: a) ti dorëzojë kryetarit të këshillit kopje të udhëzimeve e rregullore të ministrit që u përkasin veprimtarisë së institucionit.

Përgatitur nga: Prof. Dr. Edmond Rapti